



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 28.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 26.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Besa Security" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211** nxjerr:

### VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim dhe anulim e Operatori Ekonomik "**Besa Security**" e datës 26.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211** kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 19.10.2020, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet Njoftimi i Autoritetit Kontraktues** i publikuar me datë: 19.10.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit të datës 19.10.2020*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "Besa Security" me datë 26.10.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-3238-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


-Pretendimet tuaja duke përfshirë edhe kërkesën për anulim janë në kundërshtim me Urdhëresën e OSHP-se numer 563/20 të datës 14.10.2020 dhe si të tilla janë të pa bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimin e paraqitur më lartë dhe në sqarimet e dhena ne Vendimin per zbatim te Urdhhereses te OSHP-se vendosi si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

## KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Komuna e Prishtinës

Për aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës Ri-vlerësim"

Nr. i Aktivitetit të prokurimit: 619 19 3238 211

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK : "Besa Security"

Jusuf Gërvalla nr.64

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10 000

(Kodi postar)

049788887

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Granit Hasani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

granit.hasani@besasecurity.com

(Adresa elektronike)

26.10.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)



### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kritëri për dhënie të kontratës].

-Njoftimi për kontratë I publikuar me datë 16.05.2019  
-Afati I fundit perdorzim ka qenë 13.06.2019 dhe të njejtën ditë është bërë hapja e ofertave.,  
-Kriter për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me qmim më të ulët  
-Njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues për dhënie të kontratës më datë 19.10.2020,  
-Letra standarde për tenderuesit eliminuar me dt.19.10.2020

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Në pajtim me nenin 108A të LPP parashtroj kërkesë për ri-shqyrtim kundër njoftimit për dhënie të kontratës dhe letrës standarde për tenderuesit e eliminuar lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës Ri-vlerësim"  
Nr. i Aktivitetit të prokurimit: 619 19 3238 211 të inicuar nga AK-Komuna e Prishtinës.  
Nga AK kemi pranuar njoftimi për dhënie të kontratës me dt.19.10.2019.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

*AK me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe atë të neneve si më poshtë:  
Neni 1,  
Neni 7,  
Neni 56.3,  
Neni 57,  
Neni 59,  
Neni 61 dhe  
Neni 72*

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

*Në pajtim me dispozitat e nenit 108A parashtrojm këtë kërkesë për ri-shqyrtim pranë AK Komuna e Prishtinës me rastin e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit përmes njoftimit si dhe rekomandimin e OE për kontrat njoftimi për dhënie të kontratës me dt.19.19.2019 me qërast AK ka bërë:*

*-Shkelje esenciale të dispozitave të LPP dhe*

*-Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendejes faktike.*

*Se AK Komuna e Prishtinës ka bërë vërtetim të gabuar të gjendejes faktike është e evidente sepse me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e në veqanti me rastin e ri-vlerësimit, në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 merr vendim me të cilin rekomandon OE të pa përgjegjshëm vetëm duke u bazuar në urdhëresën e panelit shqyrtues të OSHP-ës eedhe për kundër që paneli shqyrtues ka gjetur se OE i rekomanduar për kontratë ka qmimet jo-normalisht të ulëta dhe disa pozicione për numrin e orëve të natës ka dhënë mundësin e intetpretimeve të ndryshme.*

*Rekomandimi për kontratë i OE i cili nuk ka plotësuar kushtin prej 250 euro pagë për punëtorët është në kundërshtim me kërkesat e DT dhe NJPK sepse në specifikimet teknike të detyrueshme është kërkuar që paga bruto të jetë 250 euro. AK-Komuna e Prishtinës fare nuk është marr me këtë qështje por vetëm në arsyetimin e tyre ka konstatuar se ka rrespektuar urdhëresën e panelit shqyrtues të OSHP pa e bërë vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve.*

*Cili është veprimi i AK lidhur me tenderët jo-normalisht të ulët në këtë rast ndaj OE të*

rekomaduar për kontratë, nga DT dhe shkresat e lëndës Aknuk gjejmë se ka matr veprime lidhur me sqarimet ndaj OE të rekomanduar për kontratë dhe AK ka qen i detyruar të kërkoj se si ka ardh deri te qmimet e ofruar nga ky OE.

Pavarsisht nga kjo OE nuk ka përmbush kushtin e kërkuar prej 250euro bruto për punëtor andaj ofetta e tij është në kundërshtim me specifikat teknike të DT. AK me rastin e vlersimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e DT dhe NJPK vlerësimi i tyre është bërë në kundërshtim me nenin 1 dhe 59 të LPP.

Bazuar në të cekuart më lartë AK nuk ka bërë vlersimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59.4 të LPP.

Paragrafi 4 i nenit 59 të këtij ligji, përcakton, citojmë:

"4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Pavarsisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekun e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

AK me eliminimin tonë si OE të cilit kemi pas ofertën tonë me qmim më të ulët ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat i nenit 1.1 të LPPës:

" 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Bazuar në të cekurat më lartë gjejmë se AK me rastin e ri-vlersimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP Barazia në trajtim/jo diskriminim citat i nenit 7.1. "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë jo diskriminuese".

Po ashtu edhe dispozitat e nenit 56.3 e qartësojnë këtë qështje sepse nuk mund të vlersohet të eliminohet apo rekomandohet një OE për kontratë për një kërkesë, kriter apo specifikim i cili nuk ka qenë kërkesë e DT dhe njoftimit për kontratë citat i kësaj dispozite:

" 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Andaj bazuar në të gjeturat e cekura më lartë i rekomandojmë Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës që më rastin e rishqyrtimit të kërkesës sonë të merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "Besa Security" shpk lidhur me aaktivitetin e prokurimit për tenderin: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës Ri-vlerësim" Nr. i Aktivitetit të prokurimit: 619 19 3238 211 të inicuar nga AK-Komuna e Prishtinës.

*2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimiti "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës Ri-vlerësim"  
Nr. i Aktivitetit të prokurimit: 619 19 3238 211 të inicuar nga AK-Komuna e Prishtinës.  
dhe të rekomandohet për kontratë OE "Besa Security" shpk.*

## **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

*Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,  
Shpenzimet e përgaditjes së tenderit,  
Sigurimi i tenderit,  
Shpezimet e ankesës.  
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë  
Fitimi i planifikuar për këtë tender*

## **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) njoftimi për dhënie të kontratës,*



## Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë, 19.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, sipas urdheresës së OSHP-së numer 563/20 të datës 14.10.2020; në bazë të nenit 59 pika 1 e LPP-ik numer 04/L-042 dhe nenit 40.13 të RRUOPP-së, nxjerr :

### V E N D I M

#### PER REKOMANDIM TE DHENJES SE KONTRATES SIPAS URDHERESSES

Urdheresa e OSHP-së ka detyruar Autoritetin Kontraktues që të zbatojë me përpikëri Vendimet paraprake me numër 332/20 dhe 82,83 dhe 90/20. Bazuar në urdheresë Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka analizuar me kujdes këto Vendime dhe rekomandimet nga urdhëresja dhe ka konstatuar si vijon:

-Me Vendimin numër 82,83,90/20 tri ankesa të OE-ik "ISA SHPK&Nazeri 2000"; "Besa Security"; dhe "Rojet e Nderit" janë trajtuar si pjesërisht të bazuara dhe është konstatuar se OE-ik i propozuar për dhenje të kontratës është i pa përgjegjshëm. Në bazë të këtij Vendimi është bërë rivlerësimi i aktivitetit dhe është propozuar për dhenje të kontratës OE-ik "Rojet e Nderit". Në këtë rekomandim është ankuar OE-ik "Isa&Nazeri" dhe Paneli i OSHP-së ka trajtuar këtë ankesë si të bazuar në Vendimin numër 332/20. Autoriteti Kontraktues ka bërë përpjekje që të respektojë të gjitha rekomandimet nga Vendimi i lartcekur, por sipas Urdheresës së OSHP-së rrjedh se të njëjtat nuk janë respektuar sa duhet. Vlen të ceket se sipas Urdheresës rezultojnë se nuk mund të bëhet anulimi i aktivitetit, nëse nuk plotësohen kërkesat e nenit 62 të LPP-së, prandaj Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk plotësohen të njëjtat dhe për këtë është i detyruar që aktivitetin ta përbyllë me Vendim për dhenje të kontratës.

Bazuar në faktin se OE-ik "Rojet e Nderit" ka qenë i rekomanduar për dhenje të kontratës, por që është konstatuar nga Urdheresa se nuk është propozim në pajtim me Vendimet paraprake të OSHP-së dhe se OE-ik "Besa Security" ka kërkuar anulimin e aktivitetit konstatohet se të njëjtat nuk mund të jenë edhe me tutje kandidat që mund të rekomandohen për dhenje të kontratës. Sipas këtij konstatimi rrjedh se vetëm ankesa e OE-ik "Isa&Nazeri" është OE-ik në të dy Vendimet e cekura në urdheresë është trajtuar si e bazuar dhe sipas rekomandimit të përsëritur disa here në të gjitha Vendimet e



OSHP-se per respektim te nenit 1 te LPP-se. Bazuar ne kete rrjedh se ky eshte OE-ik i vetem i pergjegjshem sipas Vendimeve te cekura ne Urdherese dhe Zyrtari pergjegjes i prokurimit e propozon te njejtin per dhenje te kontrates me cmimin total per tridhjte e gjashte muaj prej 2.379,456.00 euro (cmimi per ore pune 1.70 euro).

### A r s y e t i m

Zyrtari pergjegjes prokurimit ka analizuar te gjitha aktivitetin duke perfshire te gjitha Vendimet e OSHP-se dhe veprimet e Autoritetit Kontraktues dhe konstaton se e vetmja mangesi ne tere kerkesat e AK-se ka qene fakti se ne disa pozicione per sigurim nuk ka percaktuar numrin e oreve te nates (pozitat 8 ore, 12 ore dhe 16 ore) dhe kjo ka dhene mundesi te interpretimeve te ndryshme lidhur me kerkesen e AK-se per analize financiare dhe ka shkaktuar ankesa te vazhdueshme. Autoriteti Kontraktues edhe sipas interpretimit te ATK-se ka konstatuar se disa OE-ik perfshire edhe OE-ik qe tani rekomandohet per kontrate nuk kane ofruar analize e cila deshmon se mund te paguajne pagat bruto prej 250.00 euro per punetor, por kjo eshte refuzuar nga eksperti shqyrtues dhe Paneli i OSHP-se, me arsyetimin se sipas Rregullave per tenderet jonormalisht te ulet AK-ja nuk ka pase te drejte te kerkoj sqarime per qmimet e dhena nga tenderuesit.


Bazuar ne te gjitha keto atehere mbetet qe OE-ik i propozuar per dhenje te kontrates te respektoj te gjitha deklarimet e tij ne oferte duke perfshire edhe deklarimin se do te paguaj pagat bruto prej 250.00 euro.

#### Perfundim:

Nga te gjitha argumentet e paraqitura kam vendosur qe te respektoj sa me drejte Urdheresen e OSHP-se dhe sipas te gjitha analizave nga dokumentet paraprake rekomandoj qe ne kete aktivitet per dhenje te kontrates te rekomandohet OE-ik "ISA SHPK & Nazeri 2000" me cmimin total per periudhen tridhjte e gjashte mujore prej 2.379,456.00 euro, respektivisht me cmimin prej 1.70 € per ore pune.

Obligohet zyrtari qe administron kete aktivitet qe te publikoj menjehere Njoftimin e AK-se per kete Vendim dhe njekohesisht te njoftoj lidhur me kete Organin Shqyrtues te Prokurimit si deshmi per respektim te Urdhereses.

Zyrtari pergjegjes i Prokurimit



(Zeke Bardhaj)